

DIREKTIVA E MBROJTJES 2019

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) në përmbushje të misionit kushtetues, detyrimeve ligjore edhe gjatë vitit 2018 kanë arritur rezultate të prekshme në të gjithë fushat e veprimtarisë së tyre. Gjatë vitit 2018 është rritur niveli i gatishmërisë operacionale të Forcave të Armatosura, si dhe sistemi i stërvitjes së tyre ka pësuar përmirësime të ndjeshme.

Përfundimi i dokumentit të Rishkimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM) të Republikës së Shqipërisë dhe një sërë dokumentesh të tjera në fushën e legjislacionit, rritja e transparencës në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare, vijimi i procesit të modernizimit në infrastrukturë dhe pajisje, i janë përgjigjur dhe kanë mbështetur veprimtarinë e strukturave të FARSH-it në të gjitha nivelet.

Mjedisi i siguri në planin global, rajonal dhe kombëtar vazhdon të jetë nën presionin e ndryshimeve të vazhdueshme, por dhe të papritura, si rrjedhojë e rritjes së rivaliteteve gjeopolitike, shfaqjes gjithnjë e më agresive të shteteve me qëndrim jomiqësor ndaj Perëndimit, politikave të tij integruese ekonomike, politike dhe siguri në rajone të ndryshme, përfshirë Ballkanin Perëndimor, të shoqëruara me shfaqjen e kërcënimeve dhe rreziqeve të reja. Në përshtatje të këtij mjedisi sigurie, FARSH kanë përmbushur me sukses detyrimet e tyre në zhvillimin e kapaciteteve operacionale dhe aftësive të nevojshme të mbrojtjes.

Rezultate të prekshme janë arritur në fushën e modernizimit. Zbatimi i projektit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore të Republikës së Shqipërisë, kompletimi i anijeve të klasit "Iliria" me sistemin e armatimit bashkëkohor, zbatimi i projekteve riparim-shërbim për Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare, blerja e pajisjeve individuale të ushtarakut, kompletimi me armatim individual të standardit të NATO-s apo edhe pajisja me mjete transporti të blinduara (HMMWV) për struktura të Forcës Tokësore kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme në rritjen e operacionalitetit dhe ndërveprimit të strukturave të FARSH-it.

Pjesëmarrja e trupave të FARSH-it në misionet e drejtuara nga NATO-ja është rritur ndjeshëm gjatë vitit 2018, duke iu përgjigjur ndryshimeve të mjedisit të siguri dhe nevojës së përhershme për të treguar prezencën e Aleancës. Certifikimi i Grup-Batalionit të Këmbësisë së Lehtë (GBKL), pjesëmarrja në operacionet "RSM" Afganistan, "KFOR" Kosovë, në detin Egje, si dhe vazhdimësia e pjesëmarrjes në "enhanced Forward Presence - eFP" dhe Forcën e Reagimit të Menjëhershëm të NATO-s (VJTF), janë tregues të marrjes së përgjegjësisë në Aleancë, pikërisht për të forcuar këtë prezencë. Gjithashtu, ka vijuar me sukses përmbushja e detyrimeve në misionet e Bashkimit Evropian në EUTM Mali dhe në EUFOR "ALTHEA" në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Angazhimi i Forcave të Armatosura në përballimin e emergjencave civile, mbështetja ndaj komunitetit dhe institucioneve të tjera e kanë rritur imazhin dhe besueshmërinë e institucionit të Forcave të Armatosura, por në të njëjtën kohë kanë rritur edhe pritshmërinë ndaj tyre.

Të gjitha këto procese dhe aktivitete japin vlera reale dhe të prekshme kur orientohen dhe kanë objekt dhe subjekt personelin e Forcave të Armatosura. Zbatimi dhe realizimi efektiv i proceseve, aktiviteteve dhe masave të mësipërme kërkon një impenjim dhe angazhim gjithpërfshirës për t'i bërë Forcat e Armatosura një vend të dëshiruar për të zhvilluar karrierën ushtarake. Detyra jonë është të mendojmë dhe të veprojmë për të rekrutuar dhe për të mbajtur në radhët e Forcave të Armatosura qytetarë të përkushtuar të shoqërisë sonë.

DREJTIMET KRYESORE PËR VITIN 2019

Nisur nga përgjegjësitë kushtetuese, misioni, detyrimet ligjore të FARSH-it, si dhe të detyrimeve që burojnë nga NATO-ja, objektivi kryesor do të jetë realizimi dhe plotësimi i nivelit të ambicjes të parashikuar në Strategjinë Ushtarake të RSH-së. Për këtë qëllim, nëpërmjet harmonizimit dhe sinkronizimit të planifikimit të mbrojtjes me planifikimin kombëtar dhe me procesin e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s, gjatë vitit 2019 do të punohet për këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i mjedisit të sigurisë dhe përshtatja ndaj tij;
2. Përmirësimi i kuadrit ligjor;
3. Zhvillimi dhe modernizimi i kapaciteteve të mbrojtjes dhe infrastrukturës;
4. Motivimi i personelit dhe rritja e profesionalizmit;
5. Vijimi i angazhimeve, rol aktiv dhe besueshmëri në arenën ndërkombëtare;
6. Efektshmëri në menaxhimin e emergjencave civile dhe ndihmë ndaj komunitetit;
7. Rritja e transparencës nga të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura.

Bazuar në drejtimet kryesore të punës për vitin 2019, veprimtaria e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe FARSH-it të fokusohet në:

1. Vlerësimi i mjedisit të sigurisë dhe përshtatja ndaj tij.

Kërcënimet dhe rreziqet në mjedisin e sigurisë në Republikën e Shqipërisë, gjithashtu si vend anëtar i NATO-s, në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme do të ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e kapaciteteve përkatëse të FARSH-it dhe në spektrin e operacioneve të tyre. Kjo kërkon nga FARSH-i dhe strukturat e MM-së identifikimin, njohjen dhe vlerësimin e këtyre kërcënimeve dhe marrjen e masave për përballimin e tyre, të cilat do të ndikojnë pozitivisht në menaxhimin e situatës së sigurisë në vendin tonë.

Përmbushja sa më mirë e misionit kushtetues të FARSH-it, në kushtet e ndryshimeve në mjedisin e sigurisë, të natyrës dhe formave të kërcënimeve dhe rreziqeve, do të kërkojë që aftësitë dhe kapacitetet tona të inteligjencës të vazhdojnë të mbështesin autoritetet e drejtimin dhe komandimit të FARSH-it me informacion mbi këto ndryshime, si dhe identifikimin e

paralajmërimin në kohë mbi kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë së FARSH-it në venddislokimet e përhershme dhe zonat e dislokimeve dhe operacionet brenda dhe jashtë territorit të vendit.

Ndryshimet klimatike po karakterizohen nga vështirësitë në parashikime të sakta, si dhe rritjen e shkallës shkatërruese të fenomeneve natyrore. Kërcënimet që paraqesin këto ndryshime klimatike, kërkojnë që strukturat e MM-së dhe FARSH-it t'i përgjigjen me planifikim të masave dhe me zhvillim kapacitetesh operacionale të duhura në përgjigje të emergjencave civile.

2. Përmirësimi i kuadrit ligjor.

Të vijojë mbështetja me bazën e nevojshme ligjore për zbatimin e ligjit për statusin e ushtarakut, për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik, si dhe për përmirësimin e ligjit për gradat dhe karrierën ushtarake. Rishikimi i ligjit për emergjencat civile; hartimi i akteve nënligjore për funksionimin e Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake; krijimin dhe funksionimin e elementëve të Forcës Rezervë; hartimin e projektakteve për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Me përparësi të jetë hartimi i projektakteve për vijimin e procesit të trajtimit dhe reduktimit të pronave jashtë Planit të Vendorsjes dhe Përhapjes të FARSH-it.

3. Zhvillimi dhe modernizimi i kapaciteteve të mbrojtjes dhe infrastrukturës.

Modernizimi është një proces i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm që strukturat përkatëse duhet të udhëhiqen me maturi dhe inteligjencë. Ky proces të synojë zhvillimin dhe sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për të vepruar në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me aleatët në operacione dhe misione ushtarake, si dhe përballimin e emergjencave civile.

Të vijojë implementimi i Paketës së Objektivave të Kapaciteteve për zhvillimin e kapaciteteve të luftimit, mbështetjes me luftim dhe mbështetje me shërbime të luftimit. Objektivat e Kapaciteteve t'i nënshtrohen një vlerësimi real, duke harmonizuar sa më mirë kërkesat e NATO-s dhe mbështetjen financiare në përputhje me programet e mbrojtjes.

Gjithashtu, të vijojnë investimet për përmirësimet e infrastrukturës për jetesë, edukim/stërvitje, mbështetje të operacioneve dhe komandim-kontrollit të strukturave ushtarake në kohë paqeje, krize e lufte për secilin komponent të FARSH-it.

Prioritetet kryesore në fushën e modernizimit të kapaciteteve të mbrojtjes dhe përmirësimi i infrastrukturës për vitin 2019 të jenë:

- Vijimi i modernizimit të strukturave në përbërje të Grup-Batalionit të Këmbësores së Lehtë (GBKL), me synim konsolidimin e mëtejshëm të aftësive operacionale të GBKL-së, të reparteve dhe nënreparteve të deklaruara në *“enhanced NATO Response Force”*

(eNRF), Grupit Tokësor të Operacioneve Speciale (*Special Operation Land Task Group - SOLTG*), kapaciteteve të mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime të luftimit. Të mbahet nivel i lartë gatishmërie, si dhe mbështetje logjistike në të gjitha nivelet e komandim-kontrollit (C2) për të reaguar me shpejtësi ndaj krizave të paparashikuara;

- Krijimi i kapaciteteve operacionale për vëzhgimin dhe monitorimin e hapësirës ajrore të RSH-së, si dhe përmirësimin e koncepteve operacioneve për përdorimin e helikopterëve në skenarë dhe situata të ndryshme operative. Një rëndësi e veçantë t'i kushtohet bashkëpunimit dhe koordinimit me strukturat kombëtare dhe të NATO-s, për zbatimin e projektit “Alb-NATO Project” në Bazën Ajrore të Kuçovës. Stërvitja ajrore të synojë mbështetjen e Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë për përdorimin e helikopterëve në fushëbetejë, mbështetje e operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit (SAR) në tokë dhe në det, si dhe konsolidimin e standardeve të kërkuara për pjesëmarrje në stërvitje të përbashkëta me vendet e NATO-s;
- Mbajtja e një tabloje të njohjes së situatës detare, nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të hapësirës detare, si dhe ngritja e kapacitetit për komunikimin e sigurt nëpërmjet Sistemit Ushtarak të Menaxhimit të Mesazheve si një kusht për përmbushjen me sukses të detyrave në “Standing NATO Maritime Group 2”, për vitin 2019;
- Rritjen e aftësisë reaguese të Forcës Detare nëpërmjet një gatishmërie të lartë operacionale dhe koncepte më fleksibël në përdorimin e tyre;
- Përmbushja e angazhimeve për ngritjen e Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.

4. Motivimi i personelit dhe rritja e profesionalizmit.

4.1. Burimet njerëzore.

Transformimi i vazhdueshëm i mjedisit të sigurisë kërkon një përshtatje të vazhdueshme të Forcave të Armatosura ku vëmendje e përhershme duhet t'i kushtohet një ndër elementëve kryesorë të burimeve të mbrojtjes, konsolidimit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, gjatë gjithë ciklit jetësor të personelit në uniformë. Menaxhimi i burimeve njerëzore të udhëhiqet nga:

- *Besueshmëria*, duke siguruar dhe duke zhvilluar procedura transparente për të gjithë personelin;
- *Kompetenca*, duke u përditësuar në mënyrë konstante për t'iu përgjigjur nevojave të vazhdueshme të FARSH-it;
- *Iniciativa*, duke shoqëruar procesin e menaxhimit me ide të reja, duke identifikuar dhe duke përmirësuar mangësitë e mundshme në sistemin arsimor ushtarak;
- *Motivimi*, duke siguruar një mbështetje të plotë dhe përkujdesje të vazhdueshme në rritje ndaj personelit.

Personeli është aseti kryesor i Forcave të Armatosura, baza e kapaciteteve operacionale dhe të mbrojtjes. Për këtë arsye, motivimi i personelit nëpërmjet trajtimit progresiv me paga dhe vështirësi për kushte të veçanta pune, me përkujdesje efektive shëndetësore, transparenca, meritokracia dhe ofrimin të shanseve të barabarta për arsimim, për zhvillim në karrierë dhe

përmirësimi i politikave sociale, do të jetë politikë prioritare përgjatë gjithë ciklit jetësor të ushtarakut. Gjithashtu, gjatë vitit 2019, të vijojë eksperienca pozitive e përfituar në programin “Rini-Talent-Mundësi-Dinjitet”, duke i orientuar të rinjtë në respektimin e vlerave kombëtare, duke synuar freskimin e rradhëve të FARSH-it me personel të ri të përkushtuar. Rekrutimi të bëhet nëpërmjet një marketingu profesional, bazuar në nevojat aktuale dhe të perspektivës së FARSH-it, duke iu përshtatur zhvillimeve demografike dhe teknologjisë së informacionit.

Të punohet për arritjen dhe ruajtjen e përfaqësimit me 15% të femrave në uniformë në rekrutim e promovim. Prespektiva gjinore të jetë pjesë e politikave dhe planeve të strukturave të Ministrisë së Mbrotjtjes dhe SHPFA-së, jo vetëm në përfaqësim, por edhe në përgjegjësi. Të vijojë procesi i hedhjes së të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për të gjithë personelin aktiv, rezervë/lirim, si dhe shtetasve që kanë kryer shërbim e detyrueshëm ushtarak aktiv.

4.2. Arsimimi dhe stërvitja.

Natyrë e paparashikuar e operacioneve ushtarake na detyron që, pavarësisht përgatitjes apo edukimit në radhët e FARSH-it, secili duhet të jetë i vetëdijshëm se asnjëherë nuk kemi mjaftueshëm dije mbi strategjitë, teknologjitë, kulturën apo edhe vetë kundërshtarin. Arsimimi të bazohet në konceptin e ri arsimor, trajnimin individual dhe kolektiv dhe të jetë më përputhje me misionin dhe detyrat kryesore të FARSH-it. Për sa më sipër, sistemi i arsimimit ushtarak të bazohet në:

- *Teknikë analitike*, përjasje sa më reale dhe integrimin e saj në dokumentet strategjike;
- *Frymëzim dhe risi* në mënyrën e mendimit dhe organizimit pedagogjik;
- *Diversitet*, ku eksperienca dhe krijimtaria e secilit student, si dhe shkëmbimi i tyre të jenë shtesa kryesore.

Fokusi i punës të jetë zhvillimi i punës kërkimore dhe mendimit doktrinar në përputhje me zhvillimin aktual dhe të pritshëm të mjedisit të sigurisë në funksion të rritjes së cilësisë dhe profesionalizimit të personelit ushtarak dhe civil të strukturave të Forcave të Armatosura në të gjitha nivelet.

Stërvitja duhet të udhëhiqet nga parimi i përshtatjes së planeve stërvitore, sipas specifikave ku do të veprojnë njësitë ushtarake. Stërvitjet paradislokuese duhet të vazhdojnë të shtrihen në të gjitha trupat pjesëmarrëse në operacionet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke shtuar autonominë e komandantëve të kontingjenteve në njohjen e mjedisit operacional.

Të sinkronizohen stërvitjet kryesore kombëtare me ato të Aleancës dhe të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për pjesëmarrje në stërvitjet ndërkombëtare në kuadër të Aleancës apo edhe ato rajonale. Stërvitjet ndër-institucionale të vazhdojnë të zhvillohen si një instrument më shumë, me qëllim arritjen e një shkalle të lartë koordinimi dhe bashkëpunimi midis strukturave përgjegjëse kombëtare. Sistemi i mësimave të nxjerra të synojë përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit të strukturave të FARSH-it, rritjen e aftësive operationale.

4.3. Gatishmëria dhe operacionaliteti.

Mbatja e aftësive operacionale nëpërmjet rritjes së ndërveprueshmërisë, qëndrueshmërisë, përshtatshmërisë dhe përdorimit të teknologjisë me qëllim parësor përmbushjen e misionit kushtetues, garantimin e sovranitetit kombëtar dhe integritetit territorial të vendit. Prioritet të vazhdojë të jetë vijimi i angazhimeve operacionale dhe kontributi i Forcave të Armatosura në mbështetje të tri detyrave kryesore të Aleancës. Forcat e Armatosura dhe gjatë vitit 2019 të vijnë kontributin e tyre në misionet/operacionet e drejtuara nga NATO-ja, BE-ja dhe OKB-ja. Rëndësi të veçantë t'i kushtohet materializimit të pjesëmarrjes të FARSH-it në misionin e Kombeve të Bashkuara.

Pjesëmarrja në iniciativat ndërkombëtare dhe rajonale t'i shërbejë rritjes së profesionalizmit dhe ndërveprimit të FARSH-it me Aleancën, rritjes së rolit dhe besueshmërisë së tyre në rajon dhe më gjerë. Angazhimi i tyre në mbështetje të komunitetit, si përgjigje e parë ndaj operacioneve të emergjencave civile, do të vazhdojë të konsiderohet si një detyrë kryesore në kohë paqeje.

4.4. Burimet materiale.

Burimet materiale të synojnë mbështetjen e veprimtarisë së strukturave të FARSH-it dhe konceptit të përdorimit operacional të tyre në kohë paqe, krize dhe lufte. Të realizohet mbështetja e strukturave, të cilat do të jenë/janë të gatshme të përmbushin misionin kushtetues dhe të marrin pjesë në operacionet ushtarake të Aleancës. Gjithashtu, një rëndësi e veçantë t'i kushtohet mbështetjes së strukturave që angazhohen në përballimin e emergjencave civile.

Mbështetja shëndetësore të synojë realizimin e masave parandaluese dhe trajtimin shëndetësor të personelit të FARSH-it. Rëndësi t'i kushtohet trajtimit mjekësor të personelit që angazhohet në misione jashtë vendit, para, gjatë dhe pas përfundimit të detyrës.

Mbështetja dhe ndihma ndaj komunitetit të fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës, në zona të largëta, pastrimin dhe certifikimin e zonave të ndotura nga municionet e paplasura, si dhe në vazhdimin e angazhimeve në ndihmë të institucioneve të tjera të vendit.

Trajtimi i pronave jashtë Planit të Përhapjes dhe Vendosi të FA-së të realizohet bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore nëpërmjet privatizimit, qiradhënies, transferimit, regjistrimit, si dhe aplikimit për certifikatë të çdo prone në administrim të strukturave të saj.

4.5. Burimet financiare.

Buxheti i mbrojtjes të planifikohet dhe të shpenzohet me efektivitet, duke siguruar mbështetjen e balancuar midis zërave buxhetorë me synim sigurimin e mbështetjes me përparësi të nevojave të personelit dhe rritjen e shpenzimeve kapitale për modernizimin e kapaciteteve operacionale dhe infrastrukturës prioritare. Disiplinimi me përgjegjshmëri i

buxhetit vjetor të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe respektimi i kërkesave buxhetore dhe mbështetja e programeve të Mbrojtjes duhet të jenë kushtet thelbësore të cilat do të na mundësojnë opsione të favorshme në fushën e mbrojtjes. Gjatë vitit 2019 të punohet për harmonizimin sa më të mirë të programeve të mbrojtjes me programet buxhetore, duke reduktuar volumin e punës dhe duke sinkronizuar përpjekjet për përcaktimin e prioriteteve dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të buxhetit.

5. Vijimi i angazhimeve, rol aktiv dhe besueshmëri në arenën ndërkombëtare.

5.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Bashkëpunimi ndërkombëtar të jetë në harmoni të plotë me objektivat e politikës së jashtme, në mbështetje të proceseve integruese të vendit tonë në BE, në interes të zhvillimit të kapaciteteve të FARSH-it dhe të synojë rezultate në modernizim, edukim, trajnim dhe stërvitjet e përbashkëta.

Angazhimi në NATO dhe bashkëpunimi me vendet partnere të ketë si prioritet aktivitetet, të cilat mbështesin misionin kushtetues të FARSH-it, zhvillimin dhe zbatimin e Paketës së Objektivave të Kapaciteteve. Gjithashtu, 10-vjetori i anëtarësimit të vendit tonë në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) të jetë një ngjarje e veçantë për Forcat e Armatosura të RSH-së, për kontributin dhe angazhimin e tyre për sigurinë kombëtare, euroatlantike dhe atë globale. Fokusi, krahas aktiviteteve jubilarë, të jetë zhvillimi i stërvitjes shumëkombëshe “Albanian Effort 19”.

Kryesimi i Komitetit të Inteligjencës Ushtarake (MIC) të NATO-s, gjatë vitit 2019 nga Shqipëria, të jetë prioritet kryesor për strukturat e inteligjencës, me qëllim përmbushjen e objektivave të Inteligjencës së Aleancës dhe të detyrimeve kombëtare.

Të vijojë angazhimi aktiv, përfaqësimi cilësor në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të NATO-s, BE-së, OKB-së, OSBE-së apo nismave rajonale për rritjen e masave të mirëbesimit, paqes, sigurisë në rajon dhe më gjerë.

5.2. Bashkëpunimi rajonal.

Bashkëpunimi rajonal të synojë ndërveprimin për çështje të ndryshme ushtarake, si: arsimimi, trajnimi, stërvitja, pjesëmarrja në operacione të përbashkëta, si dhe mbështetjen e proceseve integruese euroatlantike të rajonit.

Marrja e kryesimit të radhës së iniciativës rajonale të SEDM-it (2019-2021) dhe Kartës së Adriatikut (A-5) të jenë prioritete kryesore në kuadër të bashkëpunimit rajonal.

6. Efektshmëri në menaxhimin e emergjencave civile dhe ndihmë ndaj komunitetit.

Në fushën e emergjencave civile të përmirësohet kuadri ligjor dhe strukturor i Sistemit të Mbrojtjes Civile, modernizimi i tij, për të siguruar jetën e qytetarëve, për të minimizuar humbjet materiale, dëmtimet e pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit.

Të vijojë konsolidimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit si struktura kryesore në menaxhimin, koordinimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe emergjencave civile. Një vëmendje e veçantë t'u kushtohet koordinimit dhe bashkëpunimit me të gjithë aktorët kombëtarë, si dhe vendet aleate dhe partnere, gjatë zhvillimit të operacioneve në përgjigje të emergjencat civile.

Gjithashtu, rëndësi t'i kushtohet hartimit të planeve rezervë për përballimin e emergjencave civile, si dhe planifikimit të rezervave të nevojshme materiale.

Bashkëpunimi ndërinstitucional me organet e pushtetit qendror dhe atë lokal dhe median të jetë cilësor dhe i drejtuar nga parimi *"risku zero nuk ekziston"*, në funksion të realizimit me sukses të paralajmërimit dhe angazhimeve në mbështetje dhe ndihmë të komunitetit.

7. Rritja e transparencës nga të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura.

Të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura të fokusohen në rritjen e transparencës dhe luftës kundër korrupsionit. Vëmendje e vecantë t'i kushtohet transparencës në menaxhimin e personelit, shpenzimit të fondeve publike, sistemit të kërkesë-ankesave të personelit, si dhe programit "Shqipëria që duam".

PËRFUNDIME

Viti 2019 është një vit i rëndësishëm për FARSH-in, pasi përkon me 10-vjetorin e anëtarësimit të vendit tonë në Aleancë, prandaj për zbatimin e kësaj direktive kërkoj nga të gjitha strukturat e MM/FARSH-it të hartojnë plane e programe konkrete veprimi, si dhe të marrin të gjitha masat për realizimin në kohë të tyre.